



Republika e Kosovës
Republika Kosova



Komuna e Istogut
Opština Istok

R A P O R T I P U N Ě S S Ě

KUVENDIT KOMUNAL

PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR 2014.

Qëllimi

Ky raport, para së gjithash ka për qëllim informimin e drejt dhe të saktë të institucioneve qendrore dhe komunale e mbi të gjitha informimin e qytetarëve të Komunës së Istogut, organizatave joqeveritare, shoqërisë civile dhe çdo grupi tjetër të interesit, për nivelin e angazhimit dhe funksionimit të Kuvendit Komunal karshi sistemit juridik të vendit dhe obligimeve që dalin nga ky sistem.

Në këtë Raport janë përfshirë të dhënat e përgjithshme të punëve dhe aktiviteteve të Kuvendit Komunal dhe trupave të Kuvendit sipas mandatit dhe përgjegjësi që kanë.

Vlerësojmë se prezantimi i aktiviteteve të Kuvendit në këtë Raport gjatë kësaj periudhe raportuese, do të shërbejnë në të mirë të proceseve të vetëqeverisjes lokale, ngritjes së përgjegjësisë dhe efikasitetit në punë të delegatëve të Kuvendit dhe ekzekutivit e në interes të qytetarëve që ata përfaqësojnë.

Prandaj, nga vështrimi ligjor, me nenin 4 të LVQL dhe nenit 1. të Statutit të Komunës së Istogut, Komuna përkufizohet si njësi themelore e organizimit të pushtetit dhe vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e përbërë nga të gjithë qytetarët në kuadër të territorit të përcaktuar me ligj, ndërkaq, në bazë të nenit 10 të të njëjtit ligj dhe

Raporti i punës

nenit 11 të Statutit të komunës organet kryesore të Komunës janë Kuvendi Komunal dhe Kryetari i Komunës.

Nga ky përcaktim ligjor, Kuvendi Komunal definohet si organi më i lartë përfaqësues dhe vendimmarrës i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejt me mandat 4-të vjeçar.

Përbërja e Kuvendit:

Kuvendi Komuna në bazë të nenit 36 par.36.1 pika d) përbëhet prej 27 delegatëve të zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejt nga qytetarët me të drejt vote në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale me mandat 4-tër vjeçar.

Struktura dhe përfaqësimi i Kuvendit:

Kuvendi Komunal në Istog përfaqësohet nga 7 (shtat) subjekte politike dhe një kandidati pavarur.

- | | |
|------------------------------|----------------|
| 1. LDK – përfaqësohet me ... | 12. delegat, |
| 2. AAK- “ / “ me ... | 6. delegat, |
| 3. PDK - “ / “ me... | 4. delegat, |
| 4. VV - “ / “ me... | 1. delegat , |
| 5. AKR- “ / “ me... | 1. delegat, |
| 6. GBI- “ / “ me... | 1. delegat, |
| 7. GIS- “ / “ me .. | 1. delegat dhe |
| 8. AE- “ / “ me ... | 1. Delegat |

Është me rëndësi të thuhet se 30 % e numrit të delegatëve përfaqësohet nga gjinia femërore ,ndërsa karakteristik e kësaj është se 99% e përfaqësimit të tyre në kuvend vinë në bazë të numrit të votave të fituara drejtë për së drejti nga zgjedhësit e jo vetëm për plotësimin e kuotës.

Vlen të theksohet se në kuadër të kuvendit nga tri subjektet politike më të mëdha veprojnë 3. (tri) grupe kuvendare nga LDK-ja ,AAK_ja dhe PDK-ja.

Komitetet dhe Këshillat e Kuvendit Komunal

Që në mbledhjen e parë të Kuvendit Komunal të legjislaturës së pestë në kuadër të Kuvendit Komunal në bazë të ligjit janë themeluar dy Komitete obligative, Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Komiteti për Komunitete (KKK) me mandat 4-tër vjeçar.

Raporti i punës

Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet prej 7 anëtarëve: 3 nga LDK, 2 nga AAK dhe 1 nga PDK, si dhe Kryesuesi i Kuvendit i cili me automatizëm është anëtar por edhe Kryesues i Komitetit, të gjithë delegat të Kuvendit. Ky komitet përfaqësohet vetëm me një femër, ndërkaq,

Komiteti Komunal për Komunitete përbëhet prej 5 anëtarëve : 2 nga radhët e LDK, një nga AAK, një nga GIB i cili është edhe kryesues i Komitetit, një nga GIS dhe një nga IRDK i cili nuk është delegat i Kuvendit. Edhe ky komitet përfaqësohet vetëm me një femër.

Veç kësaj me propozim të Kryetarit të Komunës e me vendim të Kuvendit komunal është themeluar edhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) prej 25 anëtarëve dhe Grupi joformal i Gruas me mandat 4 vjeçar si dhe disa komisione me mandat të përkohshëm siç janë Komisioni për emërtimin e rrugëve në qendrat urbane dhe fshatra, i përbërë prej 5 anëtarëve , të gjithë delegat të Kuvendit, Komisioni për vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të patundshmërisë sipas ankandit, Grupi punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit etj.

Puna dhe aktivitetet e Kuvendit Komunal dhe trupave të saj

Kuvendi Komunal , në pajtim me funksionimin dhe kompetencave që ka në bazë të nenit 40 të LVL por edhe përgjegjësi të tjera ligjore me përgjegjësi dhe përkushtim gjatë kësaj periudhe raportuese i ka mbajtur gjithsej 17 mbledhje. Në përjashtim të mbledhjes së parë inauguruese dhe mbledhjes solemne të mbajtur për nder të Shpalljes së Pavarësisë së shteti të Kosovës, të gjitha mbledhjet kanë pasur karakter pune. Prej tyre 16 mbledhje kanë qenë të rregullta, ndërsa një ka qenë e jashtëzakonshme. Gjatë gjitha këtyre mbledhjeve të Kuvendit janë trajtuar dhe shqyrtuar gjithsej 55 pika të rendit të ditës pa llogaritur pikat e zakonshme të Rendit të ditës, arsyetimi i mungesave dhe miratimi i procesverbaleve dhe nëse llogarisim kohën mesatare prej së paku 3 orësh për secilën mbledhje del se për të gjitha mbledhjet e Kuvendit sa janë mbajtur, delegatët e Kuvendit dhe anëtarët e ekzekutivi kanë zhvilluar debat për rreth 48 orë. Lidhur me këtë, lirisht mund të konstatojmë se të gjitha këto pika të rendit të ditës paraprakisht janë shqyrtuar edhe në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa të cilat çdo herë janë shqyrtuar para mbajtjes së mbledhjeve të kuvendit dhe për secilën pikë pas shqyrtimit Komiteti ka nxjerrë rekomandime të cilat i janë dërgua Kuvendit Komunal për shqyrtim. Është me rëndësi të thuhet se të gjitha rekomandimet e KPF dërguar Kuvendit për shqyrtim janë mbështetur dhe përkrahur në mënyrë unanime, gjë që tregon një harmoni në mes tyre. Ndërkaq, Komiteti për Komunitete gjatë kësaj periudhe raportuese i ka mbajtur gjithsej 6 mbledhje. Në vështrim të pjesëmarrjes së anëtarëve në mbledhje e thirrura nuk ka ndodhë asnjëherë që për shkak të mungesës së kuorumit të shtyhet mbajtja e mbledhjeve as të Kuvendit e as Komiteteve edhe pse ngandonjëherë ka pasur

mungesa të arsyeshme po edhe të pa arsyeshme nga delegatët e kuvendit dhe anëtarëve të komiteteve.

Sa i përket punës dhe efikasitetit të Kuvendit,gjatë periudhës raportuese Kuvendi ka miratuar 3 rregullore të reja për lëmi të ndryshme e që drejtpërdrejtë ndërlidhen me interesin e qytetarëve siç është Rregullorja për dhënie të subvencioneve,Rregullorja e tatimit në pronë dhe për transportin rrugorë, ndërkaq 3. Rregullore ekzistuese i janë nënshtruar procedurave për ndryshim dhe plotësim si dhe Statuti i komunës,gjithashtu ka miratuar 2. Plane strategjike dhe ka miratuar edhe 44 vendime tjera për fushat të ndryshme.

Raporti financiar

Sipas pasqyrave të buxhetit të miratuar për vitin 2014 vërehet se për Kuvendin Komunal në Istog, në kategorinë ekonomike për paga dhe mëditje kanë qenë të planifikuara 82.002 euro,ndërkaq, në kategorinë ekonomike për mallra dhe shërbime kanë qenë të planifikuara gjithsej 7.000 euro.

Nga ky vështrim,mund të konstatojmë se shuma e mjeteve të planifikuara në kategorinë ekonomike për paga dhe mëditje realisht është shpenzuar sipas planifikimit,ndërkaq, nga kategoria ekonomike për mallra dhe shërbime përveç mjeteve të planifikuara me ridestnim nga e njëjta kategori ekonomike të programit tjetër buxhetor, pra nga Administratës janë zotuat dhe shpenzuar edhe mjetet tjera të nevojshme për blerjen e llap-topëve për të gjithë delegatët e kuvendit në shumë të përgjithshme prej 10.350. euro, dhe një shpenzim tjetër prej 42,00 euro për një drekë zyrtare për Grupin joformal të gruas.

Mardhënjet e Kuvendit Komunal me institucionet qendrore, lokale dhe organizatat tjera

Mardhënjet dhe bashkëpunimi me institucionet qendrore e posaçërisht me MAPL si autoritet mbikëqyrës i qeverisjes lokale, ka qenë në nivel të mirë. Sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë së akteve,gjatë periudhës raportuese kemi pasur vetëm një vendim i cili është vlerësuar si i kundërligjshëm,i cili vendim si i tillë është rishqyrtuar në afatën ligjor, ndërkaq të gjitha aktet tjera janë konfirmua si të ligjshme. Vërejtje mund të paraqitet në disa vonesa për konfirmimin e akteve.

Kuvendi komunal gjatë kësaj periudhe bashkëpunim shumë të mirë dhe të suksesshëm në përgjithësi ka pasur edhe me ekzekutivin e Komunës e në veçanti me Kryetarin e komunës i cili jo vetëm që ka qenë prezent gati në gjitha mbledhjet e Kuvendit dhe Komitetit për Politike dhe financa po se gjatë këtyre mbledhjeve ka qenë shumë i hapur,konstruktiv, i përkushtuar,kritik por edhe vetëkritik si dhe kreator dhe

Raporti i punës

iniciues i shumë çështjeve të rëndësishme me interes të përgjithshëm për shqyrtim dhe debat.

Pa dyshim se bashkëpunim të mirë kemi pasur edhe me Asociacionin e Komunave të Kosove (AKK) e në veçanti me Kolegjiunin e Kryesuesve të Kuvendeve Komunale i cili vepron në kuadër të këtij Asociacioni, anëtar i të cilit jemi edhe ne. Pastaj me OSBE-në, Policinë e Kosovës, KFOR-in, shoqërinë civile, grupet e interesit, qytetarët dhe mediat.

Ndërkaq, e veçanta e këtij kuvendi gjatë kësaj periudhe ka qenë krijimi dhe ndërtimi i mardhënjeve të shëndosha në mes delegatëve, mundësia dhe diskutimet e hapura dhe konstruktive si tregues i kultivimit dhe zhvillimit të një demokracie të shëndetshme brenda kuvendit, si dhe qëndrimi parimor, objektiv dhe i përgjegjshëm i delegatëve ndaj çështjeve me interes të përgjithshëm dhe interesit të qytetarëve të cilët i përfaqësojnë.

Sfidat e Kuvendit Komunal gjatë periudhës raportuese.

Z do mend se gjatë kësaj periudhe raportuese Kuvendi Komunal përveç sukseseve ka pasur edhe sfida dhe probleme në realizimin e objektivave dhe synimeve të saj. Një nder sfidat më të theksuara gjatë punës së kuvendit për vitin që po e lëmë pas ka qenë çështja inferioriteti dhe mos interesimi i qytetarëve por edhe shoqërisë civile në përgjithësi në shfrytëzimin e të drejtës dhe fuqizimin e rolit të tyre në vendimarrje. Prandaj, kjo do të mbete si sfidë edhe në të ardhme dhe obligim i yni për të gjetur format më të mira për motivimin dhe zgjimin e interesimit të tyre në shfrytëzimin e të drejtës dhe ndikimit që mund të kenë ndaj institucioneve në vendimarrje. Pastaj shqetësim tjetër ka qenë mos angazhimi i duhur gruas në ngritjen dhe fuqizimi i rolit të saj në shoqëri dhe vendimarrje dhe përfaqësimi jo adekuat e saj në institucione në përgjithësi. Gjithashtu çështje tjetër e që ndoshta ka pasur edhe ndikim negativ në motivimin e tyre për angazhimin edhe më të madh në rolin e delegatit në kuvend, dhe gjetiu ka qenë pamundësia e jonë për të ndikuar në institucionet përkatëse në realizimin e kërkesës sonë për ngritjen e pagave apo renditjeve të tyre. Pengesë për realizimin e disa objektivave tjera të kuvendit e konkretisht pamundësia e themelimit të komiteteve konsultative dhe komisioneve tjera ka qenë implikimi buxhetor dhe si sfidë tjetër ka qenë çështja e transmetimit të drejtpërdrejtë të mbledhjeve të Kuvendit e që për qëllim ka pasur përmirësimin e transparencës së organeve komunale në raport me qytetarët dhe organizatat joqeveritare.

Prandaj, të gjitha këto shqetësime dhe sfida mbeten të realizohen vitin që vjen, mbase me planin e punës për vitin 2015. Kanë hyrë si objektiva dhe synime të kuvendit. Prandaj mbi bazën e informacioneve të paraqitura dhe rezultateve të arritura lirisht mund të konkludojmë se Kuvendit Komunal në përgjithësi për këtë vit të raportimit ka

treguar një performancë të mirë çka do të thotë se ka qenë i suksesshëm dhe funksional,

Në fund fare, pa u keqkuptuar ,për sukseset e arritura dhe funksionalizimin e kuvendit dhe trupave të saj gjatë këtij viti, ndjejë obligim moral që si Kryesues i Kuvendit, me respektin më të madh iu shprehi mirënjohje dhe faliminderimet më të sinqerta së pari Ju të nderuar delegat të Kuvendit, Kryetarit të Komunës Drejtor, zyrtar ,përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, bartës të institucioneve qeveritare dhe joqeveritare, shoqërisë civile dhe qytetar për kontributin dhe angazhimin e juaj për arrijten e këtij suksesi.

Ndonëse rezultatet e arritura gjatë këtij viti raportues kanë qenë mjaft inkurajuese, megjithatë, nuk ka vend për vetëkënaqësi, po ky duhet të na shërbej si motivim më i madh në angazhimin dhe përkushtimin tonë të përbashkët për realizimin e të gjitha objektivave dhe synimeve të planifikuara për një të ardhme më të mirë më shpresëdhënëse dhe prosperuese për të gjithë qytetarët e komunës sonë, pavarësisht përkatësisë së tyre etnike, gjinore, fetare, racore dhe politike.

Me dt.14.01.2015.

I s t o g

Kryesuesi i Kuvendit,

Hazbi Bajra